

METO MUHO

Sypatzembuz
në
fuztunë

BIBLIOTEKA
SHTETIT

81H-1
MI 98



VARGJE
RAPSODIKE

81H-1
NI 98

METO MUHO

SYPATREMBUR
NË FURTUNË

Vargje rapsodike



SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

OXUM OTUM

Redaktor: **Lirim Deda**

Kopertina nga: **Hiqmet Agolli**



BUÇET KËNGA

Gërnetë me çiftelinë
bie me hare,
për Enverin, për Partinë
po këndojmë ne.

Se na suallën lirinë
dhe jetën e re;
sa lart e ngritën Shqipërinë
gjithë bota e njeh.

Ndezur janë si yj' të zjarhtë
me dritë e ide,
prijnë për në komunizëm
mes furtunave.

SI LULJA U THAVE

O manushaqja me erë,
zbardh e skuq flokët e verdhë,
vetullzezë, symështjerrë,
ndrit si hëna në pranverë.

Nëna jote me mblesërinë
ty të prishi dashurinë,
të dha plakun për parinë
dhe paran' për lumturinë.

— Poliksen, që ndrit si hëna,
ç'ke që s'qesh, të keqen nëna?
Për atë që më rreh zemra
m'u prek mushkëria brenda!

Për klimë të ngjitën në male,
të ushqenin nëpër stane,
me qumsht, mish e bukëvale,
po ti si lulja u thave.

1940

FYELLI I BARIUT

Bariu në male
me kërrab' në dorë,
me shark e llabane
në shi e në borë;

verës në luginë
fyellit i bie,
nëpër trendelinë
bukur e me shie.

Ku bëjnë mërzhimnë
fyelli s'pushon,
gjithë melodinë
kopesë ja kushton;

historin' në hie
çdo ditë e lexon,
fyelli në korie
për Partinë ushton.

NË PËRVJETORIN E BATALIONIT

Ecnit monopatesh, nën dritën e hënës,
herë ja krisnit pushkës, herë ja merrnit
këngës.

Vite porsi ujërat, hej sa shpejt që rodhët,
ju ecët ndër vite, ecët, si s'u lodhët!

Flakët nëpër këmbë, e ju përmbi flakë
e tashti sërish ja u mblodhët prapë,

Rrini ju të heshtur për shokët e vrarë
te këta flamuj, këta lapidarë.

Buçet bulevardi kur parakaloni,
radhët s'mbeten bosh, shikoni... shikoni.

Eeni bulevardit, nän dritën e hënës,
herë brohorisni, herë ja merrni këngës.

KUSHTUAR USHTAR ZENUNIT

Me shërbim u nise
maleve përjetë,
Hekuran Zenuni, ushtar i vërtetë;

ecje përmbi borë,
pyllitë pa fletë,
Hekuran Zenuni, ushtar i vërtetë,

Tufani shtrëngoi,
përpiqeshin retë,
Hekuran Zenuni, ushtar i vërtetë.

Bora floqe-floqe
rrugën ta humbet,
Hekuran Zenuni, ushtar i vërtetë.

Nga ndërgjegjja e lartë
s'u ktheve në qytet,
Hekuran Zenuni, ushtar i vërtet'.

Ushqimet për shokë
i kishe amanet,
Hekuran Zenuni, ushtar i vërtet'.

Emri yt n'ushtri
s'harrohet për jetë
Hekuran Zenuni, ushtar i vërtetë.

NATËN E FUNDIT NË SHËRBIM

Lirimin e more, s'ike në shtëpi,
nuk të ndahej shpirti për at' shoqëri;
në mest të dëfrimit, ç'qe ajo ndodhi,
me alarm u nisët, ti re në pusi.
Një bandë shfarose, u vrave dhe ti.
sazet gjëmonin për ty në shtëpi.
I gjith' farefisi të pinin dolli.
Mëma qe shqetsuar, seç ndjente në gji,
nusja hynte e dilte, kish një sëkëlldi, . . .
mu në mest të këngës u vjen lajmi i zi.
Djali yt, moj nënë, ra për Shqipëri.
Ajo u përgjigjet: «Të rrojë Enveri! . . .
Bir, hallall t'u bëftë të pirët në gji;
sazet të mos ndalen, bini përsëri!
Rexhua s'ka vdekur, se rron në ushtri,
në natën e fundit trim re në kufi».

NUSJA

Ç'të bëjë nusja e gJORë
mbetet me legen në dorë,
nuk luan nga rrëza e murit,
lan për ditë këmbët e burrit!

Mos luaj, moj pëllumbeshë,
vjen dhe vjehrra me xhaxheshë...
Ç'të bëjë nusja e gJORë,
po u lan këmbët me dorë,

mos luaj, nusja e Tefikut,
se do t'i lash këmbët mikut...
(Ç'të bëj nusja e gJORë,
mbeti me legen në dorë).

Nusja nga turpi i duroi,
era e këmbëve e helmoi,
e gjora as bukë nuk ha
në fytyrë u tret, u tha!

1946

SHQIPËRIA VEND I BUKUR


Shqipëria buzë detit
gjelbëron,
ullinj, vreshta, portokalle
dhe limon;

Shqipëria vend i vogël
në Ballkan,
tok' e saj plot minerale
anëmban';

Shqipëria vend i bukur
për zili,


ndaj e kanë armiqt' e egër
në lakmi;

Shqipëria shkëmb i fortë
në stuhi,
kush i bie murit me kokë,
a derëzi!



KËNGË PËR FERIT BREGASIN

Aeroplanët venë e vinë,
lagin vendin me benzinë,
kërcet topi e mortaja,
ndizet flakë e tërë maja.
Po nuk jepet komisari
mu si hekuri te zjarri,
pozicionin s'e lëshon,
mbi shkëmbinj si shkëmb qëndron.



MITRALIERIT

Na rreh topi dhe mortaja,
pëlçet predha, ushton pllaja,
bëhen gropa, bora nxihet,
lart në majë dhe shkëmbi thyhet.

Në Verushën¹⁾ e paepur
dyzet ditë krisma s'pushoi.
Bajram Taka²⁾, mu si hekur,
«Bredën» kurrë s'e lëshoi.

1) Verusha është një fshat i Malit të Zi, ku janë zhvilluar luftime të gjata dhe shumë të përgjakshme.

2) Bajram Taka nga Golemi i Gjirokastrës ishte shembull heroizmi dhe trimërie.

Breshër plumbat, mbi mburojë,
vërshëllejnë, nxjerrin flak'.
Mitralieri s'do të dijë,
që sheh bluzën tërë gjak.

«Breda» kosit pa pushuar,
tejpërtej o në një grykë,
thyhen, bien të tmerruar
qindra nazist' e çetnikë.

DITAR I SHKRUAR ME GJAK

(Dëshmorit Mersin Çulli)*

Pesë ditë luftë brigat e tretë,
Peja më çdo an' ushton.
Përmbi male tremben retë,
mbi Lumbardh' sulmi vazhdon.

Komisari nëpër flakë
si një shkëmb xhaden' blokon,

*) Dëshmori LNÇI u vra më 15 dhjetor 1944 në Lumbardhë të Gjakovës. Ishte komisar batalioni në brig. III. S.

dhe pse ish skuqur me gjakë
autoblindën e shkat'rron.

Gjaku, që s'kish të pushuar,
i lag ditarin në gji,
për Kosovën e kish shkruar,
për të bëri jetën fli...

Komisari s'ka mbaruar
në ditar fjalët e ti',
si kushtrim i ka ngritur
kosovarët për liri...

NË MALIN E LIEVA-REKES

Mali i thepisur
me borë mbuluar,
shokë, duhet ngjitur
me këmb' e me duar.

Era kërcëllinë,
bora me stuhi,
dhe pse këmbët ngrinë,
s'na ndali njeri!

Batalioni katërt
me tre kompani

shpërthen mbi gjermanë
sulmin me bori.

Ngjeli¹⁾ që na printe,
mbi borë u shtri,
gjaku çurk i rridhte
nga goja në gji.

Muke²⁾ komisari
tek ngjitej në pllajë,
coptohet nga zjarri
që bën një murtajë.

Shokë ranë shumë
trembëdhjetë levendë.
S'do harrohen kurrë,
nderuan Atdhenë!

1) Ngjeli Goga ish komandant kompanie

2) Muke Ilmiu ish komisar kompanie.

SHOQES BUKURI

Natën pa hënë, nëpër borë e shi,
partizane trime, shoqja Bukuri,

u hodhe e para në sulm me bori,
partizane trime, shoqja Bukuri;

Në mest të xhadesë more një bresh'ri,
partizane trime, shoqja Bukuri;

Gjaku i kulluar t'u derdh për liri,
partizane trime, shoqja Bukuri.

Trupi yt i bukur ra në Mal të Zi,
partizane trime, shoqja Bukuri.

Lapidar në shekuj do flaç për miqësi,
partizane trime, shoqja Bukuri.

GJAKU JUAJ S'LAHET KURRË

Mbi Kuç, Kosor, vetëtika
prej mëngjezi gjer në darkë,
topi që nga Podgorica
e ndezi vendin flakë.*)

Mu si shqipet në ajri
partizanët fluturojnë,

* Kjo përleshje është zhvilluar më 6 dhjetor 1944 me forcat gjermane, që ishin grumbulluar në Podgoricë. Në këtë luftë të ashpër ra në fushën e betejës Zv/Komisari i Kompanisë Seit Leskua nga Tatzati. Në këtë betejë ranë dhe partizanët Astrit Selimi, Musa Tahiri etj. U plagosën 5 partizanë dhe partizane të brigadës VI S.

në sulm hidhen me furi,
Podgoricën ta çlirojnë.

Seit Leskua si petrit,
me dy granada në duar,
autoblindës iu vërvit,
u ndez flak' në krahuar.

Qëllon topi, po s'bën punë,
as Astriti me Musanë
shpërthyen mu si furtunë,
bënë kërdinë mbi gjermanë.

Gjaku juaj s'lahet kurrë
se skuqi borën e dhenë,
hodhi rrënjë nën gurë,
që çelin në çdo pranverë.

TRADHËTIA LAHET ME GJAK

Pranvera ish më të dalë
në maj të dyzet e dysë,
nënprefekti u zu i gjallë
në malet e Labërisë.

Jep llogari nënprefekti
për tradhëtinë që pat bërë.
Si një qen e vret Bexheti,
gëzoi Kurveleshi tërë.

Dha alarmin qeveria,
dërgoi milic' e xhandarë.
Ishte e fortë Partia,
s'la pa zhdukur tradhëtarë!

GRYKË MË GRYKË

Grykë më grykë u mbërtheve,
nazistit sytë ja shqeve,
shoku ynë Neki,*)

rrukull përmbi të u ktheve
dhe pak në Vjosë kërceve,
shoku ynë, Neki,

me bajonetë e preve,
këndoj se me gjak u leve,
Shoku ynë, Neki.

* Neki Samcai, dëshmor i Luftës nacional-çlirimtare rënë më 1943 në luftën me pushtuesit gjermanë.

KANDILI I FSHATARIT

Zbardhin kudo malet,
borà det me det,
kandili nuk falet,
partizanët pret.

Kandil' i fshatarit,
në kamare rri,
i ndrit partizanit
të hyj në shtëpi;

kandili nuk falet
lart përmbi oxhak,
partizani thahet
në zjarrin me flak'.

1943

BORA SKUQ NGA GJAKU

Dimrit nëpër borë
me pushkë në dorë
trimat partizanë
çanin si luanë.

Gërxeve me shkurre
me zhapa lëkure
në diell, në hënë,
zhveshur e pa ngrënë.

Dit' e natë marshime,
mal më mal luftime,

me këmbë të mpira,
me gishta të ngrira.

Dhe pse rrodhi shumë
gjaku pors i lumë,
bijtë e Partisë
ja falën lirisë.

DOLA PARTIZAN

— Mëmë, me shëndet,
puthëm, moj, ç'ngurron?
Do të shkoj në çetë,
ku atdheu më fton.

— Bir-o, diell t'u bëftë,
mëma s'do qaj' kurrë.
Një gjemb mos të shpoftë,
të luftosh si burrë!

Trimërisht sulmo
në maja, bregore,

armikun dërmo,
m'u kthefsh me fitore!

Dola partizan
maleve përpjetë,
shok' e shoqe kam
shqiponjat me fletë.

BUZË DETIT

Shtatë prill, gjëmonte toka
nga anijetë me topa.
Skuadriljet me aeroplanë
u vërsulë mbi Sarandë.

Shpërtheu tymi në qytet
sikur kishin zbritur ret'.
Flaka përpjet' malit ngjitej
sa dhe bari i njomë digjej.

Buzë detit lufta shtohet,
rrethimi sa vij ngushtohet.

Mitro Nivicë syziu
bersalierëtë i griu;

disa herë në det i hodhi
sa iu sos krejt municioni.
Përsëri keq u rrethua
po Mitrua*) s'u dorëzua.

*) Mitro Dhimërtika nga Nivicë-Bubari ra heroikisht duke luftuar me italianët më 7 prill 1939 në Sarandë. Kundra të njëjtit armik pat luftuar dhe babai i tij Vaso Dhimërtika më 1920.

KRISI NJË BERETË

Në mes të Tiranës krisi një beretë,
lulja e rinisë, trimi i vërtetë,

kundra zaptuesit edhe mbretit vetë,
lulja e rinisë, trimi i vërtetë;

dhe Duçen në Romë tundi si tërmet,
lulja e rinisë, trimi i vërtetë.

Vasili s'harrohet, për lirinë thërret,
lulja e rinisë, trimi i vërtetë;

në shekuj do ruhet si një amanet,
lulja e rinisë, trimi i vërtetë.

NËPËR RE SEÇ VETËTITI

Nëpër re seç vetëtiti,
shpat' e Hodos shkrepëtiti.
Nga gjëmimi shkëmbi krisi
Hodua, përpjet' një kurrizi,
pesëmijë veta nisi,
ja veshi si mizë lisi,
turqit me shpatë kositi. . .
U mund keq Sulltan Hazisi,
Karadakn' e lanetisi.
Hodua me flamur me shkabë*)

*) Më 1852 forca të shumta shqiptare, nën drejtimin e Hodo Nivicës, shkuan në Mal të Zi në luftë kundra garnizoneve turke; në të njëj-

as nga serb' e nga bullgarë
s'tundej nga viset matanë,
me gjak e mbrojti vatanë.

tën kohë luftuan dhe kundra forcave shoviniste,
që kërcënonin viset tona veriore si Kosovën,
Shkodrën dhe Ulqinin. Në këto beteja ra heroi-
kisht Hodo Nivica dhe një komandant tjetër,
Luman Kuçi nga Lekdushi.

KAPETAN ÇELO PICARI*)

Kapetan Çelo Picari,
fluturon, hëngëllit kali,
lëshon çika jatagani,
në Stamboll i vete nami.

Dhjetëmijë e ca karvani,
në ballë prin kapetani,
Berat, Luzat e Picari,
në gjak seç u mbyt Sulltani.

*) Çelo Picari, kapetani i vegjëlisë, prej 1833 gjer më 1880 udhëhoqi kryengritjet popullore kundra Turqisë.

Luani me zemër stërralli
në Athinë e Thesali
kryengritjet nuk i ndali,
mbet' flamur për vegjëli.

LUANESHA KOSOVARE

Me zjarrin në zemër
për mëmën Shqipëri
dymbëdhjet' vjet luftove
me dy-tre ushtri.

Forcat e Serbisë
të ranë në befasi,
s'donin që Kosova
të kishte liri.

Me dymijë ushtarë
u përleshe ti,

Drenica u ndez
flak' e tym i zi.

Moj Shote Galica,
për jetë lavdi,
heroinë u shpalle
nga mëma Parti.

1966

PËR TY FLASIN MALET

Në Çikën e thepisur,
lart në Labëri,
për ty flasin malet
se s'i le në zi. . .

Si shkëmbi me dallgët
u përleshe ti,
trimësh' e rrallë,
o Mara Kondi. —

Turqit i mashtrove,
i shpure në pusi,
në greminë i hodhe
armiqtë mizëri.

Dhe vet' fluturove
në krahë të lirisë,
zgjedhën s'e durove,
bijë e vegjëlisë!

Si hëna e plotë
ndrit brezit të ri,
trimësh' e rrallë,
o Mara Kondi.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Buçet kënga	3
Si lulja u thave	4
Fyelli i bariut	6
Në përvjetorin e batalionit	8
Kushtuar ushtar Zenunit	10
Natën e fundit në shërbim	12
Nusja	13
Shqipëria vend i bukur	15
Këngë për Ferit Bregasin	17
Mitralierit.	18
Ditar i shkruar me gjak	20
Në malin e Lieva-Rekës	22
Shoqes Bukuri.	24
Gjaku juaj s'lahet kurrë	25
Tradhëtia lahet me gjak	27
Grykë më grykë	28
Kandili i fshatarit	29
Bora skuq nga gjaku	30

Dola partizan	32
Buzë detit	34
Krisi një beretë	36
Nëpër re seç vetëtit	37
Kapetan Çelo Picari	39
Luanesha kosovare	41
Për ty flasin malet	43

Tir. 1000 kopje Format 60x88/32 Stash: 2204-65

Shtyp. NISH. Shtypshironjave «MIHAL DURI»
Stabilimenti «8 NENTORI» — Tiranë, 1972